

Gjon BERISHA. Revista “**Kosova**” fryt i bashkëpunimit të Institutit të Historisë-Prishtinë dhe Institutit të Historisë - Tiranë (*Bibliografi e revistës “Kosova”, 1993-2000*)

Që nga viti 1993 Instituti i Historisë i Kosovës, në vazhden e bashkëpunimit me Institutin e Historisë të Shqipërisë, filloi të nxjerrë revistën (fletushkën) “Kosova” në dy seri - në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Kjo revistë në një mënyrë apo tjetër e ndihmoi revistën tradicionale (*kuq e zi*) të Institutit të Historisë së Kosovës me të njëjtin emër - “**Kosova**”, e cila, për shkak të okupimit serb të Kosovës, nuk pati mundësi të dalë për një kohë të gjatë.

Materialet e botuara në këtë revistë janë përmbledhur kryesisht në 3 rubrika. Në rubrikën e parë janë botuar *artikuj studimorë* të fushave të ndryshme të shkencave historike, në të dytën *dokumente dhe kronika*, në të tretën *recensione, kritika dhe fjalime*.

Gjithsej gjatë viteve 1993-2000 dolën tetë (8) numra të kësaj reviste, punimet e të cilëve po i paraqesim më poshtë, të radhitura sipas alfabetit, në formë të një bibliografie të shkurtër.

ABDYLI, Ramiz

1. Adem Jashari (1955-1998).-8/2000, 25-30.
2. Kosova në vitet e kthesave me pasoja të mëdha (1912-1913).-7/1999, 13-17.
3. Politika serbe e gjenocidit ndaj Kosovës dhe shqiptarëve.-2/1994, 23-29.

AGANI, Fehmi

4. Memorandumi i Akademisë Serbe dhe çështja shqiptare.-1/1993, 23-27.

AJETI, Idriz

5. Autoktonia e Shqiptarëve të Kosovës në dritën e të dhënave gjuhësore-shqiptarët dhe gjuha e tyre.-6/1997, 5-9.

ANAMALI, Skender

6. Kosova dhe trevat etnike në hapsirat e ish-Jugosllavisë në mesjetën e hershme.-2/1994, 9-12.

ANDRIQ, Ivo

7. Elaborati i Ivo Andriqit mbi Shqipërinë më 1939.-2/1994, 49-54.

BAJRAKTARI, Jusuf

8. Aneksimi serb i Kosovës më 1945.-3/1994, 23-26.

BALLATA, Zeqirja

9. Rrjedhave të krijimtarisë muzikore ndër shekuj.-7/1999, 19-23.

BECI, Bahri

10. Popullsia e shqiptarëve në Maqedoni (të dhëna të toponomastikës dhe të dialektologjisë historike).-5/1997, 9-12.

BIBERAJ, Elez

11. Kosova fuçi e barutit në Ballkan.-3/1994, 27-34.

BICAJ, Muhamet

12. Gjendja dhe pozita e arsimit shqip në Republikën e Kosovës.-6/1997, 27-30.

BIÇOKU, Kasem

13. Hapësira gjeografike shqiptare dhe lidhjet ndërkrainore gjatë mesjetës.-2/1994, 13-18.
14. Shqiptarët për të tjerët dhe të tjerët për shqiptarët - Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.- 7/1999, 74-79.

BUGAJSKI, Janusz

15. Kosova në udhëkryq.-8/2000, 9-17.

CANA, Zekeria

16. Kosova dhe shteti i pavarur shqiptar.-4/1994, 23-26.

ÇEKU, Agim

17. Roli i UÇK-së në çlirimin e Kosovës.-8/2000, 31-39.

ÇUBRILLOVIÇ, Vasa

18. Dëbimi i shqiptarëve.-3/1994, 37-42.
19. Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re.-1/1993, 39-44.
20. Shpërngulja e arnautëve (shqiptarëve).-4/1994, 38-46.

DAKLARATA

21. Daklarata e Dr. Ibrahim Rugovës, President i Republikës së Kosovës.-3/1994, 5-6.

DOCETTE, Serge

22. Kanuni (fragment nga libri në dorëshkrim).-8/2000, 95-100.

DRANÇOLLI, Jahja

23. Kosova dhe shqiptarët në shek.XV-XVII.-8/2000, 59-66.

DYSELJE, Alen

24. A e kanë pushtuar shqiptarët Kosovën.-8/2000, 51-58.

FETAHU, Adil

25. Transformimi pronësor dhe plaçkitja e kapitalit të Kosovës nga pushteti okupues serb.-4/1994, 35-46.

FJALA

26. Fjala e bordit të redaksisë.-1/1993, 5-6.
27. Fjala e Dr. Sali Berishës, President i Republikës së Shqipërisë.-4/1994, 5

GJEÇOVI, Xhelal

28. Lëvizja Nacionalçlirimtare e Shqipërisë dhe çështja e Kosovës.-7/1999, 35-41.
29. Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj çështjes së Kosovës në vitet 1944-1948.-8/2000, 67-74.

HADRI, Ali

30. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881).-5/1977, 5-8.

HODGSON, John

31. Kolosi i brishtë” i Kosovës, Ibrahim Rugova “La question du Kosov[a]”, entretiens realizes par Marie-François Allain et Xavier Galmiche, Paris, Fayard, 1994 (bisedë me Ibrahim Rugovën).-5/1997, 47-49.
32. Recensione librash: histori dhe mitologji.-4/1994, 47-52.

ISLAMI, Hivzi

33. Një paralele midis Kosovës dhe Serbisë në perspektivën demografike.-7/1999, 25-33.
34. Realiteti demografiko-etnik dhe qëllimet e hegjemonisë serbe.-1/1993, 29-34.

ISMAJLI, Rexhep

35. Origjina e gjuhës shqipe.-1/1993, 9-14.

KADARE, Ismail

36. Aktet e dramës së Kosovës, Parathënie e veprës, Ibrahim Rugova, “ÇËSHTJA E KOSOVËS”, Marie-Françoise Allain et Xavier Galmiche, Paris, Fayard, 1994. (pjesa e parë).-5/1997, 29-36.
37. Aktet e dramës së Kosovës, Parathënie e veprës, Ibrahim Rugova, “ÇËSHTJA E KOSOVËS”, Marie-Françoise Allain et Xavier Galmiche, Paris, Fayard, 1994.(pjesa e dytë).-6/1997, 31-35.

KLINTON, Bill

38. Ne fituam... (fragment nga fjalimi i Klintonit drejtuar kombit, 10 qershor 1999).-8/2000, 7-[8].

KRASNIQI, Mark

39. Roli i kishës ortodokse serbe në politikat anti-shqiptare në Kosovë.-3/1994, 15-18.

KUSHTETUTA

40. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (pjesa e parë).-5/1997, 37-46.
41. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (pjesa e dytë).-6/1997, 39-52.

LALAJ, Ana

42. Dhuna antikushtetuese dhe i ashtuquajturit shtet juridik në Kosovë.-7/1999, 57-65.
43. Kosova nga e drejta historike në të drejtën e vetëvendosjes.-8/2000, 83-87.

MORINA, Halime

44. Raport vjetor mbi gjendjen e të drejtave e të lirive të njeriut në Kosovë gjatë vitit 1996 (KMDLNJ në Prishtinë).-6/1997, 53-57.

NASI, Lefter

45. "Rishikimi i Reformës Agrare" në Kosovë (1945-1947).-7/1999, 43-47.

NUSHI, Pajazit

46. Krimi ndaj njerëzimit dhe gjenocidi ndaj shqiptarëve të Kosovës në dekadën e fundit të shekullit njëzet (të dhëna , fakte dhe modele).-8/2000, 89-93.

OPINIONE

47. Opinione dhe paralele.-2/1994, 5-6.

PRIFTI, Kristaq

48. Çështja e bashkimit kombëtar të shqiptarëve në Kryengritjen e Shtatorit të vitit 1913.-7/1999, 7-12.
49. Konsiderata etnike dhe historike rreth çështjes së Bashkimit Kombëtar të shqiptarëve.-2/1994, 19-22.

PUTO, Arben

50. Konferenca e Londrës në dy botime.-1/1993, 19-22.

QENDRA

51. Qendra për Informim e Kosovës (QIK), Informatori ditor nr.1629, Prishtinë, 3 shkurt, *U promovua libri "Çëshja e Kosovës-një problem historik dhe aktual"*. - 6/1997, 37-38.

REKA, Blerim

52. Kontinuiteti politik, territorial dhe administrativ i Kosovës.-5/1997, 19-22.

REPISHTI, Sami

53. Koncepti i vetëvendosjes dhe aktualiteti kosovar.-2/1994, 39-44.

REXHEPI, Fehmi

54. Dokumenti që deshmon gjenocidin (Letra e Melihate Dedës dërguar Komitetit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovën, dhjetor 1944.-7/1999, 69-71.
55. Kolonizimi i Kosovës pas heqjes së autonomisë së saj nga ana e Serbisë (1990-1995) + harta *Shqipëria e Vertetë*, masa 1=1.000.000.-6/1997, 19-26.
56. Lufta e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera në ish-Jugosllavi për vetëvendosje e bashkim kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore.-2/1994, 31-37.

SEJDIU, Fatmir

57. Baza juridike politike e Republikës së Kosovës.-6/1997, 11-18.

STAVILECI, Esat

58. Ndryshimet kushtetuese dhe likuidimi i Autonomisë.-4/1994, 27-34.

STIPÇEVIQ, Aleksandar

59. Problemi i vazhdimësisë iliro-shqiptare dhe aktualiteti i saj politik sot.-4/1994, 6-15.

SHATRI, Muhamet

60. Mbi Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare në Kosovë dhe në trevat tjera shqiptare 1945-1947.-8/2000, 75-82.

SHTYLLA, Zamir

61. Deportimi me dhunë i shqiptarëve prej Kosovës dhe trojeve të tjera në mes të dy lufërave botërore.-3/1994, 19-22.
62. [Kronikë].-1/1993, 47-48.
63. [Kronikë].-3/1994, 45-47.
64. [Paraqitje].-1/1993, 37.
65. [Paraqitje].-2/1994, 47.

SHUKRIU, Edi

66. Dardania antike.-3/1994, 11-14.
67. Kosova-kontinuiteti etnik dhe historik i subjektivitetit të saj.-8/2000, 41-49.

XHAFERI, Xhafer

68. Represioni serb ndaj Universitetit të Prishtinës.-5/1997, 23-27.

XHUFI, Pëllumb

69. Shqiptarët në Mbretërinë Serbe të Nemanjidëve.-4/1994, 17-22.

VERLI, Marenglen

70. “Naçertania” e Garashaninit-baza ideologjike e programit të “Serbisë së Madhe”.-7/1999, 49-55.
71. Politika e kolonizimit sllav të trevave shqiptare në periudhën midis dy luftërave botërore (1918-1941).-5/1997, 13-17.

WOKER, William G.

72. [Biografi e shkurtër e veprimtarisë së tij në Kosovë dhe më gjerë].-8/2000, 19-23.

ZAJMI, Gazmend

73. Vazhdimësia historike e çështjes së Kosovës.-1/1993, 15-18.